



**Drejtuar:**  
**Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Republikës së Kosovës**  
**Prishtinë**

**Subjekti: Falënderim me përkushtim**

E nderuara Akademi,  
Të nderuar Akademikë,

Ndjehem shumë i nderuar për pranimin tim Anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Republikës së Kosovës. Në fund të një viti shumë sfidues, jo vetëm në aspektin shëndetësor, mora lajmin më të mirë për Vendimin pozitiv të Kuvendit të AShAK, për zgjedhjen time Anëtar i jashtëm i Institutit më të lartë shkencor.

Me këtë rast, përplot emocione, dua t'ju falënderoj përzemërsisht për mbështetjen dhe njohjen Tuaj me këtë akt. Falënderoj Institutin, Anëtarët dhe posaçërisht recensentët për Raportin dhe promovimin tim në këtë nivel. Natyrisht, kjo për mua ka edhe një domethënie të veçantë, si një ish-student i Universitetit (asokohe) të Prishtinës, universitet ky që ishte dhe mbeti dritarja më ndriçuese për ne shqiptarët e Maqedonisë, duke mos kursyer asgjë për të na mbështetur në rrugëtimet tona arsimore dhe shkencore. Sot, me këtë status të Anëtarit të jashtëm të orbitës më elitare shkencore në vend, na rikujtoni detyrimet tona kaq të mëdha ndaj Institucioneve dhe shtetit tonë të Kosovës. Me përkushtim maksimal, do të mundohem ta arsyetoj këtë vendim kaq madhor për mua dhe jo vetëm!

Bashkëpunimi ndërinstytucional në iniciativa, hulumtime, konferenca dhe projekte shkencore midis nesh, do të hapë mundësi të reja edhe për gjeneratat që na ndjekin pas, e që një pjesë bukur të mirë i kemi edhe në Universitetin tonë, të cilin unë e drejtoj sot.

Meqë jemi në prag të ndërrimit të moteve, më lejoni që Institutit Tuaj, të gjithë Ju dhe familjeve Tuaja, por edhe shoqërisë në përgjithësi, t'ua uroj Vitin e Ri 2021, me dëshirën e sinqertë për një vit të shëndetshëm, përplot përmbushje shpirtërore dhe mirëqenie shoqërore.

**Miqësisht,**  
**Abdylmenaf Bexheti**  
**Tetovë, 24.12.2020**